



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:074087

Datë: 30.11.2021

Numri i dokumentit: 02451786

**P.nr.22/2019**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të pandehurit L. G. nga fshati Tërnje, Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, i pandehur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/nr.1801/2018 të datës 03.01.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 17.11.2021, në prezencën e Prokurorit të shtetit Sadri Alija dhe të pandehurit, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.11.2021, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I pandehuri,**

L. G., me nofken G., nga i ati Q. dhe e ëma F., e lindur D., i lindur me datë ..., në fshatin Tërnje, Komuna e Suharekës, ku dhe tani jeton, me nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer, Veteran i UCK-së, i martuar, i ati i dy (2) fëmijëve, jeton nga pensioni i Veteranit të UCK-së, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë veprë penale,

### **ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, nga viti 2008 e në vazhdimësi në Rahovec, në mënyrë të kundërligjshme e pa ndonjë bazë juridike, të dëmtuarës M. G. M., nga fshati Hoçë e Madhe, me banim në Krushvac, R. Sërbisë, i ka uzurpuar pronën – banesën dy dhomëshe në katin e dytë, hyrja e dytë, në pjesën e ndërtesës 0-71510057-00686-0-9-2-8-0 në sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, ashtu që në pronën e uzurpuar ka banuar pa ndonjë bazë ligjore.

**- Me këtë ka kryer veprën penale, uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform nenit 4 par.1 pika 1.4, nenit 7, 17, 38, 69, 70, 81, dhe 82, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i shqipton:

## VËREJTJE GJYQËSORE

**Kryesit L. G., i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.**

I akuzuari obligohet që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe atë: paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) €uro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara M. M. nga fshati Hoçë e Madhe, Komuna e Rahovecit, tani me banim në Krushevac, Republika e Sërbisë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/.nr.1801/2018 të datës 03.01.2019, me të cilën e ka pandehur të pandehurin L. G., nga fshati Tërnje, Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 17.11.2021, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Sadri Alija, si dhe i akuzuari L. G..

Prokurori i shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprkasht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri L. G. ka deklaruar se: E pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ka ngarkuar prokuroria, pasi që është e vërtet se ai ka banuar në atë banesë, por të njëjtën e ka liruar para 5 muajve, dhe banesën e dëmtuara ia ka shitur dikujt tjetër. Po ashtu shton se ai ka qen i gatshëm që të arrij marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, por e dëmtuara nuk ka ardhur.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Sadri Alija, ka deklaruar se: Pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit L. G., nga se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë pas njoftimit të mjaftueshëm nga ana e gjykatës, dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet prezantuar nga prokurori i shtetit, andaj gjykatës i ka propozuar që ta pranojë pranimin e fajësisë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari L. G. dhe në kuptim të nenit 326 par. 4 të të njëjtit Kod, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit Sadri Alija, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit L. G., veprimet faktike të përshkruara në dispozitiv të aktakuzës u dëshmuara se janë të bazuara dhe të provuara me ligj. Andaj, konsideron se në veprimet e të njëjtit formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet në aktakuzë, me çka i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Gjykatës i propozoi që me rastin e llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh si rrethanë lehtësuese, posaçërisht pranimin e fajësisë si dhe faktin se pronën të cilën e ka uzurpuar e ka liruar dhe e njëjta i është kthyer pronarit. Po ashtu ka kërkuar që të njëjtit ti shqiptohet një dënimin i cili do të ndikoj pozitivisht që të mos kryej veprë tjetër penale dhe njëherit të obligohet në pagimin e shpenzimeve procedurale. Ndërsa pala e dëmtuar të udhëzohet në kontest juridiko civil.

I akuzuari L. G., në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: edhe një herë e theksoi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon prokuroria, pasi që është e vërtetë se ai ka banuar në atë banesë, por të njëjtën e ka liruar para 5 muajve, e po ashtu e njoftoi gjykatën se banesën e dëmtuara ia ka shitur dikujt tjetër. Po ashtu ka shtuar se ai ka qenë i gatshëm që të arrij marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimin, por e dëmtuara nuk ka ardhur. Andaj, duke pas parasysh të lartcekurat e lus gjykatën që me rastin e caktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë, e këtë sidomos duke pasur parasysh faktin se ai tani jeton në fshatin e tij të lindjes dhe nuk ka fare të bëjë me këtë çështje.

Gjykata, ka gjetur se i pandehuri ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu si ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Deklarata e të dëmtuarës M. M. e datës 19.11.2018;
- Raporti i oficerit i datës 07.11.2018;
- Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës; si dhe,
- Certifikata-Njësia kadastrale.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimin të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur mënyrën se si i akuzuari e ka kryer veprën penale, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, se është hera e parë që kishte rënë ndesh me ligjin, se i njëjti në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, kërkim faljen, është i martuar dhe mbajtës i familjes.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari e ka kryer veprën penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi me gjobë, është adekuat me shkallën e

rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 43 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar. 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil, sipas nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC**  
**- Divizioni Penal -**  
**P.nr.22/2019, datë 26.11.2021**

**Sekretari juridik,**  
Shani Canziba

**Gjyqtari i vetëm gjygues,**  
Ilir Rashkaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.